

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Pozicioni: Pedagog/e i/e Fizikë

Tipologjia: Me kohë të plotë

Afati i aplikimit: 13.09.2026

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana është një institucion i arsimit të lartë me 15 vite eksperiencë në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor, i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike & IT. I njohur për qasjen inovative në arsim dhe kërkimin shkencor, UMT është institucioni i parë në Shqipëri që ka integruar Inteligjencën Artificiale në të gjitha ciklet e studimit, Bachelor, Master dhe Doktoraturë, në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare, duke ofruar një formim të orientuar drejt profesioneve të së ardhmes.

UMT është i angazhuar fuqimisht në ndërkombëtarizim, duke ndërtuar partneritete me universitete dhe institucione kërkimore në Europë dhe SHBA, si dhe në krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm inovacioni dhe sipërmarrjeje, që mbështet zhvillimin e ideve dhe projekteve nga studentët dhe stafi akademik.

Përgjegjësitë kryesore:

- Zhvillimi i leksioneve, seminareve dhe/ose laboratorëve në lëndët e fushës së Fizikës;
- Përgatitja dhe përditësimi i materialeve mësimore dhe silabuseve dhe aktiviteteve të lëndëve;
- Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve praktike dhe laboratorike, sipas kërkesave të lëndës;
- Vlerësimi i studentëve dhe përgatitja e provimeve/detyrave në përputhje me procedurat akademike të UMT;
- Ofrimi i mbështetjes dhe konsultimit akademik për studentët;
- Pjesëmarrja në aktivitetet akademike, mbledhjet e departamentit dhe proceset e sigurimit të cilësisë;
- Kontributi në zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit;
- Angazhimi në kërkim shkencor dhe aktivitete akademike të Universitetit, sipas profilit dhe eksperiencës.

Kriteret dhe kualifikimet:

- Diplomë Master i Shkencave ose ekuivalente në Fizikë, Inxhinieri Fizike ose fushë të përafërt;
- Përparësi do kenë kandidatët me gradë shkencore PhD ose kualifikim akademik i avancuar në fushën përkatëse;
- Përvojë në mësimdhënie universitare përbën avantazh;
- Njohuri të mira të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies;
- Aftësi të mira komunikuese, pedagogjike dhe organizative;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip dhe në një mjedis akademik multidisiplinar.

Ne ofrojmë:

- Mundësi për t'u angazhuar në një mjedis akademik dinamik dhe në zhvillim;
- Mundësi për zhvillim profesional dhe akademik;
- Bashkëpunim me staf akademik dhe profesionistë të fushave të ndryshme;
- Kushte konkurruese angazhimi, në përputhje me eksperiencën dhe kualifikimin.

Dokumentet për aplikim:

CV e përditësuar, kopje të diplomave dhe certifikatave përkatëse dhe dokumentacion tjetër që kandidati e konsideron të rëndësishëm.

Aplikimet dërgohen në: <mailto:humanresources@umt.edu.al>

Në subjektin e email-it të shënohet: **Aplikim – Pedagog/e i/e Fizikës**